



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI MBI AUDITIMIN E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË AGJENCINË KOMBËTARE TË BREGDETIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI



MBI AUDITIMIN E “SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT” NË AGJENCINË KOMBËTARE TË BREGDETIT

Tiranë, janar 2025

PËRMBAJTJA

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4
	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4
	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	5
II	HYRJA	5
1.	Objektivat dhe qëllimi	6
2.	Identifikimi i çështjes	6
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar	6
4.	Përgjegjësitë e audituesve	7
5.	Kriteret e vlerësimit	7
6.	Standardet e auditimit	8
7.	Metoda e auditimit	8
8.	Dokumentimi i auditimit	8
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	8
1.	Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	8
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	9
2.1.	Auditimi i funksionimit të Qeverisjes dhe Investimet në TIK	
	<i>a. Verifikim i politikave, standardeve dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK.</i>	9-24
	<i>b. Investimet në teknologjinë e informacionit.</i>	
2.2	Auditimi i sistemeve dhe sigurisë së informacionit	
	<i>a. Auditimi i sistemeve mbi të dhënat Input / Output.</i>	24-28
	<i>b. Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit.</i>	
IV.	REKOMANDIME	29

LISTA E SHKURTIMEVE

Shkurtimi Emërtimi i plotë

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
AKB	Agjencia Kombëtare e Bregdetit
RSH	Republika e Shqipërisë
BCP	Business Continuity Plan
IQ	Inspektoriati Qendror
BCC	Business Continuity Center
MNSH	Marrëveshjeve Nivel Shërbimi
AK	Autoriteti Kontraktues
OE	Operator Ekonomik
TI(IT)	Teknologjia e Informacionit
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimi
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
KM	Këshilli i Ministrave
COBIT	Objektivat e Kontrollit për Informacionin dhe Teknologjinë përkatëse
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
BE	Bashkimi Evropian
SSL	Secure Sockets Layer
VPN	Virtual Private Network
LAN	Local Area Network
IP	Internet Protocol

1.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, datë 27.11.2014, zhvilloi auditimin e Teknologjisë së Informacionit në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit nga data 24.09.2024 deri më datë 11.11.2024.

Grupi i auditimit mblodhi informacione, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë dhe mbështetur në to hartoi matricat e auditimit.

Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Projekti i auditimit, për auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, është pjesë e Planit Vjetor 2024 të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH. Projektimi i këtij auditimi, është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH ka vlerësuar si të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë që Agjencinë Kombëtare të Bregdetit disponon, për të garantuar disponibilitet dhe integritet të të dhënave. Mbështetur në punën në terren, evidencat e marra kanë qenë të mjaftueshme dhe të besueshme për punën audituese. Rezultatet kryesore të punës audituese përfshihen në këtë përmbledhje ekzekutive të Raportit Përfundimtar. Auditimi i sistemeve të Informacionit është i rëndësishëm për institucionet, si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkë përdorimi i burimeve të informacionit. Siguria e Informacionit përcaktohet si mundësia e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me termat e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë. Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar përpunimin, ruajtjen, dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin e institucionit dhe funksionet e tij. Lidhur nga sa më sipër, çdo institucion shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurtisë së informacionit me elementët kyç të cilët janë: “Mjedisi i sigurtisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurtisë, Organizimi i sigurtisë së TIK, Menaxhimi i aseteve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurtisë së TIK, Menaxhimi i vazhdueshmërisë së biznesit, Përputhshmëria”.

I.2. Paraqitja e gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejtimeve më poshtë:

- Nga auditimi u konstatua se, në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit nuk ka asnjë punonjës të teknologjisë së informacionit. Për çdo problem që konstatohet në përdorimin e pajisjeve teknologjike apo sistemet që punonjësit e institucionit kanë në përdorim i përcillet për zgjidhje Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

- Nga auditimi u konstatua se nuk janë marrë masa për hartimin e rregullave dhe procedurave që rregullojnë proceset e teknologjisë së informacionit në përputhje me aktet ligjore, nënligjore dhe praktikat më të mira. Mungesa e një baze të brendshme rregullatore për funksionimin e strukturave të teknologjisë së informacionit çon në operim bazuar në ngjarje “ad hoc”, duke rritur rrezikun e ekspozimit të institucionit ndaj situatave të mundshme.

- Nga auditimi mbi sigurinë e sistemit të menaxhimit CMS u konstatuan porta të hapura të panevojshme, si 2086, 8880, 8080, 8443, të cilat mund të krijojnë vulnerabilitete serioze në këtë sistem. Këto porta mund të ekspozojnë shërbime që nuk janë të nevojshme për funksionimin e sistemit dhe mund të përdoren nga sulmuesit për të fituar akses të paautorizuar. Gjithashtu, transmetimi i të dhënave në një format të pakriptuar (p.sh., HTTP) rrit mundësinë për përgjim dhe manipulim të të dhënave.

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

-Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të marrë masa të menjëhershme për plotësimin me punonjës të teknologjisë së informacionit të sektorit të IT atashuar pranë Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, pasi mungesa e një punonjësi të dedikuar pengon veprimtarinë e institucionit për veprime operationale të vazhdueshme.

-Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa për hartimin e një Rregulloreje të Përgjithshme mbi Teknologjinë e Informacionit duke marrë në konsideratë vendosjen e kontrolleve të brendshme lidhur me menaxhimin e riskut, përputhshmërinë me procedurat dhe rregullat e brendshme aktuale.

-Agjencia Kombëtare e Bregdetit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit duhet të marrë masa për të reduktuar rrezikun nga portat e panevojshme të hapura, duke realizuar një skanim të plotë të rrjetit për të identifikuar dhe mbyllur të gjitha portat jo-thelbësore, si 2086, 8880 dhe 8080. Gjithashtu, duhet të përmirësojë rregullat e firewall-it dhe të çaktivizojë shërbimet e papërdorura për të forcuar sigurinë e sistemit.

1.3 Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit:

Grupi i auditimit është mbështetur në Standardet ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH” datë 27.11.2014. Kemi audituar Sistemet e Teknologjisë së Informacionit për periudhën ushtrimore 01.01.2022-30.06.2024 në të cilat përfshihet Qeverisja IT, Siguria e Informacionit, Investimet në fushën TIK dhe sistemet e teknologjisë së informacionit që Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka në përdorim dhe mbështet aktivitetin e saj. Mungesa e një stafi të dedikuar për teknologjinë e informacionit dhe aktet rregullatore në drejtim të sistemeve të teknologjisë së informacionit kanë ndikuar në një zhvillim të pa monitoruar të aktivitetit institucional dhe pa deleguar përgjegjësitë individuale për veprimet e kryera. Pajisjet që përdoren për shërbimet e komunikimit dhe ruajtjes së të dhënave janë në kushte jo optimale dhe nuk mbështesin sigurinë e duhur. Sistemi Elektronik i lejeve është i ekspozuar ndaj sulmeve, duke transmetuar të dhëna në mënyrë të pakriptuar.

II. HYRJJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit 1077/1 Prot, datë 24.09.2024, të miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi 24.09.2024 deri në 11.11.2024, në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, (më poshtë AKB), ku periudha e audituar është 01.01.2022 deri në 30.06.2024, u krye auditimi me objekt “Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit”, nga audituesit:

1. R. A, përgjegjës grupi
2. A. K, anëtare

II.1. Objektivat dhe qëllimi auditimit

Objekti i Auditimit TIK është përcaktimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrën e duhur duke përdorur burimet IT, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, konfidencialitetin, integritetin si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të.

Qëllimi i Auditimit TIK ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, është dhënia e opinionit apo vlerësimit nëse ekzistojnë kontrollet dhe mekanizmat e duhur me qëllim krijimin, mirëmbajtjen e burimeve IT dhe funksioneve për të cilat këto burime shërbejnë. Për të arritur në dhënien e një opinioni, janë mbledhur informacione, të dhëna dhe prova, për të përcaktuar nëse nëpërmjet teknologjisë së informacionit mbrohen asetet, ruhet integriteti i të dhënave, si dhe synimet e subjektit që auditohet arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet në mënyrë efëçente. Kërkesat për informacion sipas drejtimeve të programit të auditimit, u hartuan në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

II.2 Identifikimi i çështjeve:

Drejtimet e këtij auditimi janë bazuar në programin e auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit të protokolluar me nr.1077/1 Prot, datë 24.09.2024:

1. Auditimi i funksionimit të Qeverisjes dhe Investimet në TIK

a. Verifikim i politikave, standardeve dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK.

b. Investimet në teknologjinë e informacionit.

2. Auditimi i sistemeve dhe sigurisë së informacionit

a. Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit.

b. Auditimi i sistemeve mbi të dhënat Input / Output.

3. Të tjera

II.3 Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar

Agjencia Kombëtare e Bregdetit është person juridik, publik, buxhetor në varësi të Ministrit Përgjegjës për Turizmin, me seli në Tiranë. AKB organizohet në dy nivele:

- a) Në nivel qendror, nëpërmjet Drejtorisë Qendrore;
- b) Në nivel rajonal, nëpërmjet (4), Agjencive Rajonale;

Funksionet dhe Detyrat e AKB-së:

AKB-ja, në përputhje me kompetencat/ përgjegjësitë e veta, kryen këto detyra:

- a) Krijon dhe përditëson Inventarin Kombëtar të Zonës Bregdetare;
- b) Jep kontribut në informimin, konsultimin dhe aksesin e publikut gjatë hartimit dhe zbatimit të politikave e të strategjive të lidhura me menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;
- c) Merr pjesë në hartimin e politikave e të strategjive kombëtare për menaxhimin e integruar të bregdetit dhe bashkërendimin e punës për zbatimin e tyre;
- ç) Propozon ndryshime dhe përmirëson kuadrin ligjor e nënligjor për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;
- d) Bashkëpunon me organet përkatëse për projektet dhe aktivitetet për mbrojtjen e zhvillimin e bregdetit dhe monitorimin e zbatimit të tyre;
- dh) Nxit dhe bashkëpunon me organizma, institucione, investitorë dhe aktorë të tjerë ndërkombëtarë apo vendas dhe i fton ata për pjesëmarrje e përfshirje në projektet dhe zhvillimet me rëndësi për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;
- e) Monitoron zbatimin me përpikmëri të instrumenteve të planifikimit të territorit, të miratuara nga autoritetet qendrore e vendore në zonën bregdetare;
- ë) Kontrollon zbatimin e kriterëve dhe të kushteve nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi;
- f) Ushtron kontroll dhe inspekton në mjediset dhe në dokumentacionin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari turistike;

- g) Inspekton dhe monitoron rregulloren për disiplinimin e zhvillimit të veprimtarive turistike detare, që zhvillohen në zonën bregdetare dhe respektimin e rregullave për përdorimin e pasurisë së patjetërsueshme publike në zonën bregdetare;
- gj) Inspekton dhe kontrollon zbatimin e rregullave për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarive në stacionet e plazhit, sipas akteve nënligjore në fuqi;
- h) Merr masa, vendos gjoha/masa administrative për shkeljet e konstatuara nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat e ligjit;
- i) Shqyrton ankesat për masat administrative dhe gjobat e vendosura ndaj subjekteve;
- j) Ndjek procesin e ekzekutimit të detyrimeve monetare të subjekteve të gjobitura, me qëllim arkëtimin e shumave në favor të institucionit;
- k) Lajmëron organet shtetërore kompetente në rastet kur vërehen shkelje administrative, veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin, duke u propozuar organeve përkatëse marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës, si dhe përgatit kallëzimin penal për veprat penale të vëna re gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi;
- m) Mirëmban pajisjet dhe asetet në dispozicion për zhvillimin e veprimtarisë;
- n) Kryen detyra të tjera të dhëna me akte ligjore dhe nënligjore.

II.4 Përgjegjësitë e audituesve

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2022 deri në 30.06.2024, duke i kushtuar vëmendje mbrojtjes së aseteve të informacionit, ruajtjen e integritetit të të dhënave, sigurimin e disponueshmërisë dhe konfidencialitetit të informacionit dhe mbështetjen në kontrole të duhura.

Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban Programi i Auditimit nr. 1077/1 Prot, datë 24.09.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit, legjislacionin e fushës në të cilën operon AKB. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese, është siguruar një evidencë e përshtatshme, e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve. Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij.

II.5 Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikat më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë raport përfundimtar krahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar disa masa organizative, për përmirësimin e situatës.

Aktet ligjore dhe rregullative mbi të cilat është mbështetur vlerësimi janë si më poshtë:

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t.
- Udhëzues dhe Manuale të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit si: ISSAI 5300, Manuali Aktiv i Auditimit IT si dhe Standardet e COBIT.
- Ligji nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji Nr. 162 Date 23.12.2020 Për Prokurimin Publik.
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe aktet ligjore në zbatim të tij;
- Standardet TIK;

- Vendim Nr. 171, Datë 27.3.2019 për Miratimin e Rregullores “Për kushtet dhe Kriteret e Ushtrimit të Veprimtarisë së Stacionit të Plazhit”.
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar;
- Akte të tjera ligjore apo nënligjore që do të jenë të nevojshme gjatë auditimit.

II.6 Standardet e auditimit

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik, Standardet, dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testime dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë, duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të TIK, si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310 etj.

II.7 Metodatat e auditimit

Metodat mbi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur në AKB, janë si më poshtë:

- Intervista zhvilluar në subjekt me personat përgjegjës;
- Verifikime të sistemit si auditues;
- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullativ të institucionit;
- Analizimi i të dhënave të eksportuara nga sistemi;

II.8 Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH si dhe në manualin aktiv të auditimit të Teknologjisë së Informacionit në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, raporte të ndryshme me të dhëna nxjerrë nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

III.PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Për të arritur një menaxhim dhe mbrojtje më të mirë të pasurive natyrore bregdetare si dhe promovimin e vendit si destinacion turistik, me vendim të Këshillit të Ministrave nr.31 datë 22.01.2014, krijohet Agjencia Kombëtare e Bregdetit.

AKB-ja organizohet në dy nivele:

- a) Në nivel qendror, nëpërmjet drejtorisë qendrore;
- b) Në nivel rajonal, nëpërmjet 4 (katër) agjencive rajonale.

AKB-ja ka për mision mbrojtjen dhe zhvillimin e një mjedisi të qëndrueshëm të zonës bregdetare, nëpërmjet monitorimit dhe kontrollit të të gjithë potencialit ekzistues të zonës bregdetare e detare dhe pasurive mjedisore që përfshihen brenda saj, si dhe kontrollin e veprimtarive turistike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit.

Kompetencat/Përgjegjësitë Funktionale të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit:

- Sigurimin e performancës në zonat bregdetare;
- Organizimin e punës për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;
- Organizimin e punës për nxitjen e investimeve në zonën bregdetare;
- Organizimin e punës për bashkërendimin e programeve, të projekteve zhvilluese me rëndësi për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare;

– Sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit, nëpërmjet inspektimit dhe kontrollit të veprimtarive turistike.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Auditimi i funksionimit të Qeverisjes dhe Investimeve në TIK

1.a) “Verifikimi i politikave, standardeve dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK”

Vlerësimi i Burimeve Njerëzore

Për kryerjen e funksioneve institucionale Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka një strukturë organizative të miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 186, datë 15.11.2022 e cila është e ndërtuar mbi bazën e Drejtorive dhe Sektorëve.

Numri i përgjithshëm i punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit është gjithsej 74 nga të cilët 42 punonjës i përkasin drejtorisë qendrore dhe 32 agjencive rajonale të bregdetit Lezhë, Durrës, Vlorë dhe Sarandë.

Mbështetur në bazën ligjore, VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar me Vendim nr. 36, datë 24.1.2018, me vendim nr. 448, datë 26.7.2018, me Vendim nr.872, datë 24.12.2019.

Në kapitullin III, funksionimi dhe organizimi i AKSHI-t:

10. Në përbërje të AKSHI-t, pranë çdo institucioni dhe organi të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, krijohen dhe funksionojnë njësitë e teknologjisë së informacionit e të komunikimit (NJTIK), si strukturë organizativo-teknike për projektimin, zbatimin dhe administrimin e qeverisjes elektronike, në institucion, nëpërmjet teknologjisë së informacionit e të komunikimit (TIK).

Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka dërguar kërkesa të vazhdueshme drejtuar Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për emërimin e një punonjësi të teknologjisë së informacionit në AKB për realizimin në kohë dhe mbarëvajtjen e proceseve të punës në këtë institucion por ende nuk është atashuar asnjë punonjës për realizimin e detyrave në AKB.

Me shkresën nr. 2490 prot., datë 02.08.2023 Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit njofton Agjencinë Kombëtare të Bregdetit për dorëheqjen e punonjësit të IT.

Me shkresën nr. 2490/1 prot., datë 03.08.2023 Agjencia Kombëtare e Bregdetit kërkon AKSHI-të të caktojë një punonjës IT dedikuar vetëm AKB.


Me shkresën nr. 2490/2 prot., datë 01.09.2023 AKSHI njofton Agjencinë Kombëtare të Bregdetit se janë marrë masat për shpalljen e pozicionit vakant.

Me shkresën nr. 2490/3 prot., datë 27.10.2023 AKB ridërgon shkresë AKSHI-të për plotësimin e pozicionit IT me qëllim realizimin në kohë të afateve të caktuara dhe mbarëvajtjen e proceseve të punës në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit.

Me shkresën nr. 1980 prot., datë 03.06.2024 Agjencia Kombëtare e Bregdetit i ka dërguar përsëri Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit kërkesë për plotësimin e pozicionit të teknologjisë së informacionit me qëllim mbarëvajtjen e punës në këtë institucion.

Nga auditimi u konstatua se, në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit nuk ka asnjë punonjës të teknologjisë së informacionit. Për çdo problem që konstatohet në përdorimin e pajisjeve teknologjike apo me sistemet që punonjësit e institucionit kanë në përdorim drejtohen me shkresë zyrtare Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Rrjedhimisht ka vonesa në përgjigjet dhe zgjidhjet e menjëhershme që punonjësit e institucionit kanë në vijueshmërinë e procesit të punës i cili zhvillohet nëpërmjet sistemeve online apo edhe pajisjeve teknologjike që Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka në disponim.

Diagrama nr.1: Struktura e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit



Burimi: AKB, përpunuar nga grupi i auditimit

Verifikim i politikave dhe procedurat në TIK

Grupi i auditimit, me qëllim auditimin e nivelit të dokumentimit të politikave dhe procedurave në lidhje me teknologjinë e informacionit, verifikoi rregulloret e institucionit, si dhe udhëzime të tjera të brendshme. Auditimi për këtë çështje pati në konsideratë risqet që vijnë nga mungesa e politikave dhe procedurave të shkruara, si dhe nga praktikat me të cilat institucioni zhvillon aktivitetin e tij.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion Agjencia Kombëtare e Bregdetit sipas rregullore së brendshme miratuar me Urdhër nr. 153, datë 05.05.2023 “Për miratimin e rregullore së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”, ka si mision kryesor mbrojtjen dhe zhvillimin e një mjedisi të qëndrueshëm të zonës bregdetare, nëpërmjet monitorimit dhe kontrollit të të gjithë potencialit ekzistues të zonës bregdetare e detare dhe pasurive mjedisore që përfshihen brenda saj, si dhe kontrolli i veprimtarive turistike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit.

Nga auditimi u konstatua se, Teknologjia e Informacionit në AKB zhvillohet në kushtet e mungesës së bazës rregullatore. Në AKB në mungesë të personelit të teknologjisë së informacionit nuk ka marrë masa për hartimin e rregullave dhe procedurave të proceseve të teknologjisë së informacionit në përputhje me aktet ligjore, nënligjore dhe praktikat më të mira, duke mos konsideruar elementë të tillë si: rregulla mbi veprimtarinë e TI në institucion, rregulla mbi menaxhimin e incidenteve, procedura dhe indikatorë të matjes së performancës për gabimet/ incidentet e ndodhura dhe masat reaguese ndaj tyre. Mungesa e bazës së brendshme rregullatore për funksionimin e strukturave të teknologjisë së informacionit sjell operimin mbi baza ngjarjeje, duke rritur riskun e ekspozimit të institucionit ndaj situatave ku reagimi është i paidentifikuar, burimet njerëzore dhe përgjegjësitë të paalokuara, si dhe koha e përgjigjes e papërcaktuar.

Identifikimi dhe adresimi i risqeve në TIK

Monitorimi dhe kontrolli i riskut është procesi i identifikimit, analizimit dhe planifikimit për zbulimin e rreziqeve të reja të identifikuar, monitorimit të rreziqeve të identifikuar më parë dhe vlerësimit të atyre ekzistuese për të verifikuar strategjitë e reagimit ndaj rreziqeve të planifikuara për efektivitetin e tyre. Agjencia Kombëtare e Bregdetit nuk disponon regjistër risku për vitet 2022, 2023. Kjo në kundërshtim me nenin 11, pika 2: “Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe

realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë.”, 12 pika 3/d: “Identifikimin dhe krijimin e regjistrin të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë” si dhe nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015. Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, udhëzimi nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të gjitha niveleve”, Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

Për vitin 2024 është miratuar regjistri i riskut me urdhër nr 124, datë 05.07.2024 është caktuar koordinatori për riskun në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit.


Nga auditimi u konstatua se, në regjistrin e riskut për vitin 2024 nuk është përfshirë asnjë element nga teknologjia e informacionit si risk për këtë institucion.

Auditimi i faqes Web të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit

Në kuadrin e transparencës bazuar në Ligjin 119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka të afishuar në faqen e saj web (<https://bregdeti.gov.al/>), organigramën, legjislacionin, programin e transparencës, etj.

Nga faqja web e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit konstatuan vonesa në navigimin e faqes web e cila ndikon në aksesin e informacioneve të nevojshme për publikun:

Figura nr. 1: Faqja Web e AKB



Burimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit

- Nga auditimi u konstatua se, nuk është nënshkruar marrëveshje për shërbimet që ofron AKSHI kundrejt Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, ku të përcaktohen shërbimet e ofruara, mënyrat e raportimit, parametrat dhe niveli i ofrimit të shërbimit si p.sh. Orët/nivelet e suportit/ përgjegjësitë/ kufizimet, etj.

Në këtë marrëveshje përcaktohen parametrat dhe niveli i ofrimit të shërbimeve, përfshirë, minimalisht, këto elemente:

- a) orët gjatë të cilave shërbimet janë funksionale;
- b) disponueshmërinë e shërbimeve e kohën mesatare ndërmjet ndërprerjeve të shërbimeve;
- c) kohën mesatare të rikuperimit;
- ç) nivelet e suportit, përgjegjësitë dhe kufizimet.

Marrëveshja e nivelit të shërbimit ndërmjet AKSHI-t dhe AKB-së duhet të nënshkruhet me qëllim përcaktimin e nivelit të shërbimit që AKSHI duhet ti ofrojë këtij institucioni sipas përcaktimeve të marrëveshjeve. Synimi i marrëveshjeve është ofrimi i shërbimeve me qëllim rritjen e efektivitetit, kufizimin e risqeve teknike, ruajtjen e integritetit dhe vazhdueshmërinë e punës, etj.

1.b) “Investimet në teknologjinë e informacionit”

Për periudhën objekt auditimi Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka realizuar rreth 5 procedura prokurimi për teknologjinë e informacionit, me vlerë 466,600 lekë pa TVSH dhe 559,920 lekë me TVSH. Përkatësisht, për vitin 2022 është realizuar 1 procedurë prokurimi për mallra dhe shërbime për TI me vlerë totale 94,400 lekë pa TVSH. Për vitin 2023, janë realizuar 2 procedura prokurimi për mallra dhe shërbime për TI me vlerë totale 193,800 lekë pa TVSH dhe për vitin 2024, janë realizuar 2 procedura prokurimi për mallra dhe shërbime për TI me vlerë totale 178,400 lekë pa TVSH. Dosjet e procedurave të prokurimit publik janë të pasqyruara në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 1: Procedurat e prokurimit 2022-2024

Në lekë

Realizimet për Vitin 2022			
Objekti i procedurës	Fondi limit	Vlera e kontratës pa TVSH	Vlera e kontratës me TVSH
Blerje tonera dhe drum për printerat në përdorim të AKB-së	150,000.00	94,400.00	113,280.00
Realizimet për Vitin 2023			
Objekti i procedurës	Fondi limit	Vlera e kontratës pa TVSH	Vlera e kontratës me TVSH
Shërbim për përshtatje dhe zhvillim të faqes Web zyrtare të AKB-së	99,433.33	99,000.00	118,800.00
Blerje tonera për printera për nevoja të AKB-së për vitin 2023	129,850.01	94,800.00	113,760.00
Realizimet për Vitin 2024			
Objekti i procedurës	Fondi limit	Vlera e kontratës pa TVSH	Vlera e kontratës me TVSH
Mirëmbajtje e faqes Web të institucionit për vitin 2024	98,833.00	98,000.00	117,600.00
Blerje tonera për printera për nevoja të AKB-së për vitin 2024	139,800.00	80,400.00	96,480.00

Burimi: Të dhëna të AKB të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

✓ **Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Mirëmbajtje e faqes Web të institucionit për vitin 2024”**

Tabela nr.2: Të dhënat e prokurimit për procedurën “Mirëmbajtje e faqes Web të institucionit për vitin 2024”

A. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Mirëmbajtje e faqes Web të institucionit për vitin 2024		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 84, datë 11.04.2024	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: Z. R.M Znj. E.Sh Z. K.N	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Z. E.R Znj. M.Ç Znj. B.Ç
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë me vlerë të vogël”		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 98,833 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 98,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 833 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: -		10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender: 3 OE b) Skualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 3 OE
11. Ankimime: AK- s’ka APP- s’ka KPP -s’ka	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	
12. Lidhja e kontratës: Nr. 1029/6 prot., datë 12.04.2024	13. Vlera e kontratës (me TVSH): 117,600 lekë	14. Afati i kontratës në ditë: 8 muaj

Burimi: Të dhëna të AKB të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit

36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. Gjithashtu, edhe në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- **Hartimi i dokumenteve të tenderit:** Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

Përzgjedhja e operatorit fitues: Me shkresën nr. 1029/3 datë 11.04.2024 është mbajtur procesverbal vlerësimi i ofertave të studimit të tregut për kryerjen e këtij shërbimi për të cilin janë paraqitën tre oferta si më poshtë:

1. Operatori Ekonomik “I.” me vlerë 99,000 lekë pa TVSH;
2. Operatori Ekonomik “K.” shpk me vlerë 99,500 lekë pa TVSH;
3. Operatori Ekonomik “K.” shpk me vlerë 98,000 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr. 1029/4 prot., datë 11.04.2024 është miratuar formulari i njoftimit të fituesit nga ku u shpall fituese oferta e OE “K.” shpk me vlerë 98,000 lekë pa TVSH.

Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit: Me shkresën nr. 1029/7 prot., datë 12.04.2024 nga drejtori i përgjithshëm i AKB është ngritur urdhri nr. 85, datë 12.04.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për monitorimin e kontratës dhe marrjen në dorëzim të shërbimeve sipas kontratës së shërbimit nr. 1029/6 prot., datë 12.04.2024 me objekt “mirëmbajtje dhe menaxhim të faqes web të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”, të përbërë nga T.K. kryetar, A.M. dhe K.N. anëtarë. Në zbatim të urdhrit për zbatimin e kontratës nuk ka një procesverbal të mbajtur nga grupi i caktuar për marrjen në dorëzim të shërbimit.

Zhvillimi i kontratës:

- Me Urdhrin e brendshëm nr. 76 datë 20.03.2024 është ngritur komisioni për argumentimin e nevojave, specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit “Mirëmbajtje dhe menaxhim të faqes web të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit për vitin 2024”.

- Me shkresën nr. 1029 prot., datë 08.04.2024 komisioni i përbërë nga R.M, E.Sh dhe K.N ka bërë relacion për argumentimin e nevojave, specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit “Mirëmbajtje dhe menaxhim të faqes web të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit për vitin 2024”. Fondi limit për këtë procedurë është në vlerën 98,833 lekë pa TVSH.

- Me shkresën nr. 1029/1 prot., datë 09.04.2024 Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse i është drejtuar titullarit të institucionit për kërkesë për vijimin e procedurës për blerjen e këtij shërbimi.

- Me shkresën nr. 1029/2 prot., datë 11.04.2024 është ngritur Urdhri nr.84 datë 11.04.2024 për blerje shërbim me vlerë nën 100,000 lekë pa TVSH “Mirëmbajtje dhe menaxhim të faqes web të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”.

- Me shkresën nr. 1029/3 datë 11.04.2024 nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje E.R kryetar, M.Ç dhe B.Ç anëtarë është mbajtur procesverbal vlerësimi i ofertave të studimit të tregut për kryerjen e këtij shërbimi për të cilin janë paraqitën tre oferta si më poshtë:

1. Operatori Ekonomik “I.” me vlerë 99,000 lekë pa TVSH;
2. Operatori Ekonomik “K.” shpk me vlerë 99,500 lekë pa TVSH;
3. Operatori Ekonomik “K.” shpk me vlerë 98,000 lekë pa TVSH.

Për sa më sipër Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël ka përzgjedh fitues çmimin më të ulët të ofertuar që është K. shpk me vlerën 98,000 lekë pa TVSH.

- Me shkresën nr. 1029/4 prot., datë 11.04.2024 është miratuar formulari i njoftimit të fituesit nga ku u shpall fituese oferta e OE K. shpk me vlerë 98,000 lekë pa TVSH.

Afati i kryerjes së shërbimit është nga nënshkrimi i kontratës deri më datë 31.12.2024.

- Me shkresën nr. 1029/5 prot., datë 12.04.2024 nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël është mbajtur proceverbal i dorëzimit të dokumentacionit nga Operatori Ekonomik fitues.

- Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe Operatori Ekonomik “K.” shpk kanë nënshkruar kontratën nr. 1029/6 prot., datë 12.04.2024 për procedurën e prokurimit me objekt “Mirëmbajtje dhe menaxhim të faqes web të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit” me vlerë 98,000 lekë pa TVSH dhe 117,600 lekë me TVSH. Afati i zbatimit të kontratës është nga lidhja e kontratës deri në 31.12.2024.

- Me shkresën nr. 1029/7 prot., datë 12.04.2024 nga drejtori i përgjithshëm i AKB është ngritur urdhri nr. 85, datë 12.04.2024 Për ngritjen e grupit të punës për monitorimin e kontratës dhe marrjen në dorëzim të shërbimeve sipas kontratës së shërbimit nr. 1029/6 prot., datë 12.04.2024 me objekt “Mirëmbajtje dhe menaxhim të faqes web të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”, të përbërë nga T.K kryetarë, A.M dhe K.N anëtarë.

✓ **Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje tonera për printerat për nevoja të AKB-së për vitin 2024”**

Tabela nr.3: Të dhënat e prokurimit për procedurën “Blerje tonera për printerat për nevoja të AKB-së për vitin 2024”

A. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Blerje tonera për printerat për nevoja të AKB-së për vitin 2024		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 88, datë 03.05.2024	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: Z. E.R Znj. M.Ç Znj. B.Ç	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Z. E.R Znj. M.Ç Znj. B.Ç
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë me vlerë të vogël”		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 139,800 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 80,400 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 59,400 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 07.05.2024		10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender: 25 OE b) Skualifikuar: 20 OE c) Kualifikuar: 5 OE
11. Ankimime: AK- s’ka APP- s’ka KPP -s’ka	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	
12. Lidhja e kontratës: -	13. Vlera e kontratës (me TVSH): 96,480 lekë	14. Afati i kontratës në ditë: -

Burimi: Të dhëna të AKB të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. Gjithashtu, edhe në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kriterëve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

Përzgjedhja e operatorit fitues: Me shkresën nr. 1226/9 prot., datë 07.05.2024 nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël është mbajtur procesverbal vlerësimi ku rezulton se ishin 25 operatorë ekonomik pjesëmarrës nga të cilët u skualifikuan 20 dhe janë klasifikuar 5 prej tyre. KPVV ka shpall fitues OE B.P. me vlerë 80,400 lekë pa TVSH.

Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit: Me shkresën nr. 1226/11 prot., datë 13.05.2024 ka dalë urdhër nr. 93, datë 13.05.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për pritjen, kolaudimin dhe administrimin e mallit të kontraktuar me subjektin “B.T.” sipas specifikimeve

teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje tonera për printerat për nevoja të AKB-së për vitin 2024”.

Me shkresën nr. 1226/12 prot., datë 16.05.2024 është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim të mallit nga grupi i punës duke deklaruar se malli i furnizuar nga “B.T.” është plotësisht në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë/kontratën e furnizimit dhe merret në dorëzim nga përfaqësuesit e AKB-së.

Zhvillimi i kontratës:

- Me shkresën nr. 1226 prot., datë 24.04.2024 nga magazinieri në sektorin e financës është drejtuar me memo drejtorit të përgjithshëm në AKB për gjendjen e tonerave gjendje në magazinë dhe kërkesë për vazhdim procedure për blerjen e tonera-ve dhe drum-eve me qëllim përballimin e proceseve të punës.

- Me shkresën nr. 1226/1 prot., datë 25.04.2024 drejtori i drejtorisë së financës dhe shërbimeve mbështetëse i drejtohet komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël me kërkesë për blerje tonerash.

- Me shkresën nr. 1226/2 prot., datë 26.04.2023 është miratuar ftesa për ofertë për studim tregu nga drejtori i përgjithshëm i AKB-së.

- Me shkresën nr. 1226/6 prot., datë 02.05.2024 nga komisioni i blerjeve me vlerë të vogël është bërë përlllogaritja e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje tonera për printerat për nevojë të AKB-së për vitin 2024”. Fondi limit për këtë procedurë është përlllogaritur në vlerën 139,800 lekë pa TVSH.

- Me shkresën nr. 1226/7 prot., datë 03.05.2024 është ngritur urdhër prokurimi nr. 88, datë 03.05.2024 nga titullari i institucionit për prokurimin me vlerë të vogël “Blerje tonera për printerat për nevoja të AKB-së për vitin 2024”.

- Me shkresën nr. 1226/8 prot., datë 03.05.2024 është shpallur ftesa për ofertë miratuar nga titullari i institucionit”.

- Nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël më datë 03.05.2024 është mbajtur procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim.

- Me shkresën nr. 1226/9 prot., datë 07.05.2024 nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël është mbajtur procesverbal vlerësimi ku rezulton se ishin 25 operatorë ekonomik pjesëmarrës nga të cilët u skualifikuan 20 dhe janë klasifikuar 5 prej tyre. Nga të skualifikuarit 5 prej tyre janë verifikuar në QKB se nuk kanë lidhje me veprimtarinë që lidhet me objektin e prokurimit Operatorët Ekonomik si në vijim: “C.”, “3E C.”, “E.Z.”, “X.S.” dhe “Z.”. KPVV ka shpall fitues OE B.P. me vlerë 80,400 lekë pa TVSH.

Tabela nr.4: Të dhënat mbi operatorët e kualifikuar dhe s'kualifikuar

Kualifikuar		S'kualifikuar	
Operatori Ekonomik	Vlera	Operatori Ekonomik	Vlera
B.T.	80,400	3e C.	410,000
B.S.	114,800	A.	225,000
E.Q.	91,667	A.G.	144,800
I.O.	100,000	A.K.	225,000
L.D.	100,000	A.A.	435,990
		C.	267,000
		C.	350,120
		E.B.	412,000
		E.Z.	430,000
		G.D	366,000
		H.G.	350,000
		I. Gj.K.	235,000
		J.O.T.	425,000
		J.P. & P.	416,667
		M.M.	202,400
		O.H.	420,000

	R.	149,000
	S.	433,333
	X.S.	389,000
	Z.	275,000

Burimi: Të dhëna të AKB të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

- Më datë 08.05.2024 komisioni ka mbajtur procesverbal për konfirmimin e kryerjes së shërbimeve sipas të cilit OE ka konfirmuar kryerjen e furnizimit objekt prokurimi. Bashkëlidhur këtij procesverbali konfirmimi nga ana e OE për vazhdimin e realizimit të procedurës sipas kërkesave të ftesës për ofertë nga sistemi i prokurimit elektronik.

- Me shkresën nr. 1226/10 prot., datë 08.05.2024 komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ka mbajtur procesverbal të dorëzimit të dokumentacionit nga operatori ekonomik fitues duke deklaruar se dokumentacioni i dorëzuar është në përputhje me kriteret e vendosura në ftesën për ofertë.

- Me shkresën nr. 1226/11 prot., datë 13.05.2024 ka dalë urdhër nr. 93, datë 13.05.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për pritjen, kolaudimin dhe administrimin e mallit të kontraktuar me subjektin “B.T.” sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje tonera për printerat për nevoja të AKB-së për vitin 2024”. Komisioni përbëhet nga G.B. Kryetar, A.M. dhe E.Sh. anëtarë.

- Me shkresën nr. 1226/12 prot., datë 16.05.2024 është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim të mallit në datën 16.05.2024 nga grupi i ngritur me urdhrin nr.93, datë 13.05.2024 duke deklaruar se malli i furnizuar nga “B.T.” është plotësisht në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë/kontratën e furnizimit dhe merret në dorëzim nga përfaqësuesit e AKB-së.

Në dosjen e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje tonera për printerat për nevoja të AKB-së për vitin 2024” nuk është nënshkruar kontratë ndërmjet palëve, në kundërshtim me përcaktimet e parashikuara në nenin 85 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku parashikohet lidhja e kontratës si pjesë e dokumenteve të procedurës së prokurimit, nenin 56 pika 10 ku citohet se “Faturat e lëshuara kanë vlerën e kontratës së lidhur, kur palët nuk kanë mundur të nënshkruajnë një të tillë”, si dhe udhëzimin nr. 5 datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

- Gjithashtu, nuk është hartuar raporti përmbledhës, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të parashikuara në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku kërkohet që për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji, autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të skualifikuar etj.

- Në dosjen e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje tonera për printerat për nevoja të AKB-së për vitin 2024” nuk është mbajtur njoftimi i shpalljes së fituesit.

- Komisioni nuk ka asnjë nga anëtarët ekspert të fushës, në kundërshtim me nenin 74 i cili citon se: “Në përbërje të njësisë së prokurimit është detyrimisht, personi përgjegjës për prokurimin, dhe të paktën një specialist fushe, në rast se kërkohen njohuri të specializuara për objektin e prokurimit” dhe 75/1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 i cili parashikon se komisioni i vlerësimit të ofertave përbëhet nga jo më pak se tre persona, ku të paktën një prej anëtarëve është ekspert i fushës.

✓ **Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje tonera për printerat e AKB-së për vitin 2023”**

Tabela nr.5: Të dhënat e prokurimit për procedurën “Blerje tonera për printerat e AKB-së për vitin 2023”

A. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Blerje tonera për printerat e AKB-së për vitin 2023		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 143, datë 10.08.2023	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit:	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave:

2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë me vlerë të vogël”	Znj. G.T. Znj. M.Ç. Znj. E.D.	Znj. G.T. Znj. M.Ç. Znj. E.D.
5. Fondi Limit (pa TVSH) 129,850 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 94,800 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 35,050 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 17.08.2023	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender: 18 OE b) Skualifikuar: 14 OE c) Kualifikuar: 4 OE
11. Ankimime: AK- s’ka APP- s’ka KPP -s’ka		
12. Lidhja e kontratës: Nr. 2585/10 prot., datë 24.08.2023	13. Vlera e kontratës (me TVSH): 113,760 lekë	14. Afati i kontratës në ditë: 4 muaj

Burimi: Të dhëna të AKB të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. Gjithashtu, edhe në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

Përzgjedhja e operatorit fitues: Me shkresën nr. 2585/8 datë 18.08.2023 nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje G.T. kryetar, E.D. dhe M.Ç. anëtare është mbajtur procesverbal vlerësimi i ofertave të studimit të tregut për kryerjen e këtij shërbimi për të cilin janë paraqitur 18 oferta nga të cilat janë skualifikuar 14 dhe janë kualifikuar 4 prej tyre. Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël ka përzgjedhur fitues çmimin më të ulët të ofertuar që është “E.L.” me vlerën 94,800 lekë pa TVSH.

Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit: Me shkresën nr. 2585/13 prot., datë 24.08.2023 nga drejtori i përgjithshëm i AKB është ngritur urdhri nr. 146, datë 24.08.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të mallit dhe ndjekjen e zbatimit të kontratës. Me shkresën nr. 2585/14 prot., datë 25.08.2023 është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim të mallit nga grupi i caktuar me urdhër të titullarit duke deklaruar se malli i furnizuar është plotësisht në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë/kontratën e furnizimit dhe merret në dorëzim nga përfaqësuesit e AKB-së.

Zhvillimi i kontratës:

- Me shkresën nr. 2585 prot., datë 08.08.2023 përgjegjësi i burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse i është drejtuar komisionit të prokurimit me vlerë të vogël me kërkesë për blerje tonerash referuar gjendjes në magazinë.

- Me shkresën nr. 2585/1 prot., datë 09.08.2023 titullari i institucionit ka miratuar ftesën për ofertë për studim tregu.

- Me shkresën nr. 2585 prot., datë 10.08.2023 komisioni i prokurimit me vlerë të vogël i përbërë nga G.T. kryetar, E.D. dhe M.Ç. anëtarë ka bërë përlllogaritjen e fondit limit që është në vlerën 129,850 lekë pa TVSH.

- Me shkresën nr. 2585/6 prot., datë 10.08.2023 është ngritur Urdhër Prokurimi nr.143 datë 10.08.2023 prokurim me vlerë të vogël “Blerje tonera për printerat për nevoja të AKB-së për vitin 2023”.

- Me shkresën nr. 2585/7 prot., datë 16.08.2023 është miratuar ftesa për ofertë sipas formularit nr. 3 nga titullari i institucionit.
- Më datë 16.08.2023 komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ka mbajtur procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje tonera për printerat për nevoja të AKB-së për vitin 2023”.
- Me shkresën nr. 2585/8 datë 18.08.2023 nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje G.T. kryetar, E.D. dhe M.Ç. anëtare është mbajtur procesverbal vlerësimi i ofertave të studimit të tregut për kryerjen e këtij shërbimi për të cilin janë paraqitën 18 oferta si më poshtë:

Tabela nr.6: Të dhënat mbi operatorët e kualifikuar dhe s'kualifikuar

Kualifikuar		S'kualifikuar	
Operatori Ekonomik	Vlera	Operatori Ekonomik	Vlera
B.S.	77,800	A.	250,000
E.L.	94,800	A.K.	64,925
M.D.	99,000	A.D.	416,667
I. O.	100,000	B.T.	250,000
		C.	296,000
		C.	275,000
		E.Q.	364,166
		F.N.	0
		I. Gj.K.	200,000
		J.	444,000
		J.O.T.	475,000
		O.M.	464,000
		R.	275,000
		S.	450,000

Burimi: Të dhëna të AKB të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Për sa më sipër Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël ka bërë verifikimet nga QKB nga ku ka rezultuar se OE “C.”, “F.N.” dhe “J.” nuk kryejnë veprimtari që kanë lidhje me objektin e prokurimit dhe ka përzgjedh fitues çmimin më të ulët të ofertuar që është “B.S.” me vlerën 77,800 lekë pa TVSH.

- Më datë 21.08.2023 komisioni ka mbajtur procesverbal për kalimin tek operatori ekonomik i radhës dukë qenë se OE B.S. është tërhequr për arsye të gabimeve në llogaritje.
- Më datë 22.08.2023 është mbajtur procesverbal për konfirmimin e kryerjes së shërbimeve nga Operatori Ekonomik E.L. me vlerë 94,800 pa TVSH.
- Me shkresën nr. 2585/9 prot., datë 22.08.2023 nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël është mbajtur procesverbal i dorëzimit të dokumentacionit nga Operatori Ekonomik fitues.
- Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe Operatori Ekonomik “E.L.” kanë nënshkruar kontratën nr. 2585/10 prot., datë 24.08.2023 për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje tonera për printerat për nevoja të AKB-së për vitin 2023” me vlerë 94,800 lekë pa TVSH dhe 113,760 lekë me TVSH. Afati i zbatimit të kontratës është nga lidhja e kontratës deri në 31.12.2023.
- Me shkresën nr. 2585/13 prot., datë 24.08.2023 nga drejtori i përgjithshëm i AKB është ngritur urdhri nr. 146, datë 24.08.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të mallit dhe ndjekjen e zbatimit të kontratës nr. 2585/10 prot., datë 24.08.2023 me objekt “Blerje tonera për printerat për nevoja të AKB-së për vitin 2023”, të përbërë nga E.R. kryetarë, L.Sh. dhe B.Ç. anëtarë.
- Me shkresën nr. 2585/11 prot., datë 25.08.2023 është bërë plani i zbatimit të kontratës dhe me shkresën nr. 2585/12 prot., datë 25.08.2023 është dërguar Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Me shkresën nr. 2585/15 prot., datë 02.11.2023 është mbajtur formulari i zbatimit të kontratës.
- Me shkresën nr. 2585/14 prot., datë 25.08.2023 është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim të mallit nga grupi i caktuar me urdhër të titullarit duke deklaruar se malli i furnizuar nga “E.L.” është plotësisht në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë/kontratën e furnizimit dhe merret në dorëzim nga përfaqësuesit e AKB-së.

Me faturë tatimore lëshuar nga operatori ekonomik nr. 196/2023 datë 28.08.2023.

Në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka një raport përmbledhës siç parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku thuhet se për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të skualifikuar etj.

Gjithashtu nga auditimi u konstatua se për procedurën me objekt “Blerje tonera për printerat për nevoja të AKB-së për vitin 2023” mungon formulari i njoftimit të fituesit.

Nga auditimi mbi kriteret e veçanta të kualifikimit konstatohet se, argumentimi i dhënë është i përgjithshëm dhe nuk shpreh teknikisht nevojën e këtyre kriterëve për realizimin e kontratës kjo në kundërshtim me nenin 78 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për “*Miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar”, ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

Komisioni nuk ka asnjë nga anëtarët ekspert të fushës, në kundërshtim me nenin 74 i cili citon se: “Në përbërje të njësisë së prokurimit është detyrimisht, personi përgjegjës për prokurimin, dhe të paktën një specialist fushe, në rast se kërkohen njohuri të specializuara për objektin e prokurimit” dhe nenin 75/1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 i cili parashikon se komisioni i vlerësimit të ofertave përbëhet nga jo më pak se tre persona, ku të paktën një prej anëtarëve është ekspert i fushës.

✓ **Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Shërbim për përshtatje dhe zhvillim të faqes web zyrtare të AKB-së”**

Tabela nr.7: Të dhënat e prokurimit për procedurën “Shërbim për përshtatje dhe zhvillim të faqes web zyrtare të AKB-së”

A. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Shërbim për përshtatje dhe zhvillim të faqes web zyrtare të AKB-së		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 117 datë 30.06.2023	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: Znj. S.M. Z. F.V. Z. T.Q.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Znj. G.T. Znj. M.Ç. Znj. E.D.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë me vlerë të vogël”		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 99,433 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 99,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 433 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: -		10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender: 3 OE b) Skualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 3 OE
11. Ankimime: AK- s’ka APP- s’ka KPP -s’ka	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	
12. Lidhja e kontratës: -	13. Vlera e kontratës (me TVSH): 118,800 lekë	14. Afati i kontratës në ditë: -

Burimi: Të dhëna të AKB të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. Gjithashtu, edhe në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në

dokumentacion përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranim kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

Përzgjedhja e operatorit fitues: - Me shkresën nr. 1653/7 datë 03.07.2023 nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje: G.T. kryetar, E.D. dhe M.Ç. anëtare është mbajtur procesverbal vlerësimi i ofertave të studimit të tregut për kryerjen e këtij shërbimi për të cilin janë paraqitën tre oferta si më poshtë:

1. Operatori Ekonomik "I." me vlerë 99,500 lekë pa TVSH;
2. Operatori Ekonomik "K." shpk me vlerë 99,800 lekë pa TVSH;
3. Operatori Ekonomik "K." shpk me vlerë 990,000 lekë pa TVSH.

Për sa më sipër Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël ka përzgjedh fitues çmimin më të ulët të ofertuar që është "K." shpk me vlerë 990,000 lekë pa TVSH.

Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit: Me shkresën nr. 1653/9 prot., datë 11.07.2023 nga drejtori i përgjithshëm i AKB është ngritur urdhri nr. 121, datë 11.07.2023 "Për ngritjen e grupit të punës për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të shërbimit për përditësimin dhe zhvillimin e faqes web të AKB-së nga kontraktuesi "K." shpk, të përbërë nga A.V., B.Ç. dhe E.Sh.. Në zbatim të urdhrin për zbatimin e kontratës është mbajtur procesverbal nr. 1653/13 prot., datë 18.09.2023 për marrjen në dorëzim të shërbimit.

Zhvillimi i kontratës:

- Me shkresën nr. 967 prot., datë 27.04.2023 është ngritur urdhër nr. 98, datë 27.04.2023 "Për ngritjen e komisionit për vlerësimin teknik të web-faqes zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, argumentimin e nevojës, specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e kostos për përforcimin e sistemit mbrojtës dhe mirëmbajtjes së tij periodike, në rast nevoje". Komisioni është i përbërë nga S.M., F.V. dhe T.Q.. Gjithashtu komisioni do të asistohet nga G.H. specialist IT atashuar pranë AKB-së. Sipas urdhrin komisioni brenda datës 31.05.2023 duhet të hartojë një relacion përmbledhës dhe t'i paraqitet titullarit të institucionit në mënyrë të detajuar gjendja aktuale e faqes zyrtare të AKB-së.

Ky raport përmbledhës nuk është hartuar dhe nuk i është paraqitur titullarit sipas afateve të kërkesës në urdhrin e ngritur nga vetë titullari, por është hartuar më vonë se data e përcaktuar në urdhër. Relacioni për vlerësimin teknik është hartuar me shkresën nr. 1653/4 prot., datë 20.06.2023 në të cilën është përcaktuar edhe fondi limit me vlerë 99,433 lekë pa TVSH.

- Me shkresë nr. 1653 prot., datë 08.06.2023 është hartuar ftesa për ofertë për studim tregu.

- Me shkresën nr. 1653/5 prot., datë 29.06.2023, specialisti i IT atashuar pranë AKB-së ka bërë kërkesë për blerje shërbimi me objekt "Shërbim për përshtatje dhe zhvillim të faqes web zyrtare të AKB-së".

- Me shkresën nr. 1653/6 prot., datë 30.06.2023 është ngritur Urdhri nr.117 datë 30.06.2023 për blerjen me vlerë nën 100,000 lekë pa TVSH "Shërbim për përshtatje dhe zhvillim të faqes web zyrtare të AKB-së".

- Me shkresën nr. 1653/7 datë 03.07.2023 nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje: G.T. kryetar, E.D. dhe M.Ç. anëtare është mbajtur procesverbal vlerësimi i ofertave të studimit të tregut për kryerjen e këtij shërbimi për të cilin janë paraqitën tre oferta si më poshtë:

1. Operatori Ekonomik "I." me vlerë 99,500 lekë pa TVSH;
2. Operatori Ekonomik "K." shpk me vlerë 99,800 lekë pa TVSH;
3. Operatori Ekonomik "K." shpk me vlerë 990,000 lekë pa TVSH.

Për sa më sipër Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël ka përzgjedh fitues çmimin më të ulët të ofertuar që është "K." shpk me vlerë 990,000 lekë pa TVSH.

- Me shkresën nr. 1653/8 prot., datë 05.07.2023 është miratuar njoftim kualifikimi dhe dorëzim dokumentacioni për operatorin ekonomik të shpallur fituese "K." shpk.

- Më datë 05.07.2023 nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël është mbajtur procesverbal i dorëzimit të dokumentacionit nga Operatori Ekonomik fitues.

- Me shkresën nr. 1653/9 prot., datë 11.07.2023 nga drejtori i përgjithshëm i AKB është ngritur urdhri nr. 121, datë 11.07.2023 "Për ngritjen e grupit të punës për ndjekjen dhe marrjen në

dorëzim të shërbimit për përditësimin dhe zhvillimin e faqes web të AKB-së nga kontraktuesi KEMINET shpk, të përbërë nga A.V., B.Ç. dhe E.Sh.

- Për këtë shërbim është lëshuar fatura tatimore nga operatori ekonomik nr. 102/2023 datë 24.07.2023.

- Në zbatim të urdhrimit për ndjekjen dhe marrjen në dorëzim të shërbimit është mbajtur procesverbal nr. 1653/13 prot., datë 18.09.2023.

✓ **Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje tonera dhe drum për printerat në përdorim të AKB-së”**

Tabela nr.8: Të dhënat e prokurimit për procedurën “Blerje tonera dhe drum për printerat në përdorim të AKB-së”

A. Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: Blerje tonera dhe drum për printerat në përdorim të AKB-së		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 178, datë 15.11.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: Znj. G.T. Znj. E.D. Znj. M.Ç.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Znj. G.T. Znj. E.D. Znj. M.Ç.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë me vlerë të vogël”		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 150,000 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) 94,400 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 55,600 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: 16.11.2022		10. Operatorët Ekonomikë: a) Pjesëmarrës në tender: 26 OE b) Skualifikuar: 19 OE c) Kualifikuar: 7 OE
11. Ankimime: AK- s’ka APP- s’ka KPP -s’ka	9. Burimi i Financimit: Buxheti i shtetit	
12. Lidhja e kontratës: -	13. Vlera e kontratës (me TVSH): 113,280 lekë	14. Afati i kontratës në ditë: -

Burimi: Të dhëna të AKB të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

Nga auditimi u konstatua:

-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave: Specifikimet teknike të mallrave për këtë procedurë prokurimi në përgjithësi janë hartuar në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. Gjithashtu, edhe në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 12 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- Hartimi i dokumenteve të tenderit: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po ashtu, janë hartuar dhe vendosur në dokumentacion përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese.

Përzgjedhja e operatorit fitues: Më datë 16.11.2022 komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ka mbajtur procesverbal vlerësimi ku rezulton se ishin 26 operatorë ekonomik pjesëmarrës nga të cilët u skualifikuan 19 dhe janë klasifikuar 7 prej tyre. KPVV ka shpall fitues OE B.S. me vlerë 94,400 lekë pa TVSH.

Marrja në dorëzim e pajisjeve dhe shërbimit: Me shkresën nr. 2869/7 prot., datë 21.11.2022 ka dalë urdhër nr. 179, datë 21.11.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të mallit sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje tonera dhe drum për printerat në përdorim të AKB-së”.

Me shkresën nr. 2869/8 prot., datë 21.11.2022 është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim të mallit duke deklaruar se malli i furnizuar nga “B.S.” është plotësisht në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit dhe merret në dorëzim nga përfaqësuesit e AKB-së.

Zhvillimi i kontratës:

- Me shkresën nr. 2869 prot., datë 04.11.2022 përgjegjësi i burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse ka bërë kërkesë për blerje tonerash sektorit të financës, buxhetit dhe prokurimeve, për dijeni drejtorit të përgjithshëm në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit.

- Me shkresën nr. 2869/1 prot., datë 07.11.2022 titullari i institucionit ka miratuar ftesën për ofertë për studim tregu.

- Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ka mbajtur procesverbal për fondin limit të cilin e ka përllogaritur në vlerën 150,000 lekë pa TVSH. Ky procesverbal nuk ka as datë dhe as numër protokollit.

- Me shkresën nr. 2869/5 prot., datë 15.11.2022 është ngritur urdhër prokurimi nr. 178, datë 15.11.2022 nga titullari i institucionit për prokurimin me vlerë të vogël “Blerje tonera dhe drum për printerat në përdorim të AKB-së”.

- Me shkresën nr. 2869/6 prot., datë 15.11.2022 është shpallur ftesa për ofertë miratuar nga titullari i institucionit”.

- Nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël më datë 15.11.2022 është mbajtur procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim.

- Më datë 16.11.2022 komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ka mbajtur procesverbal vlerësimi ku rezulton se ishin 26 operatorë ekonomik pjesëmarrës nga të cilët u skualifikuan 19 dhe janë klasifikuar 7 prej tyre. KPVV ka shpall fitues OE B.S. me vlerë 94,400 lekë pa TVSH.

Tabela nr.9: Të dhënat mbi operatorët e kualifikuar dhe s'kualifikuar

Kualifikuar		S'kualifikuar	
Operatori Ekonomik	Vlera	Operatori Ekonomik	Vlera
B.S.	94,400	J.G.	441,667
A.P.	100,000	A.	156,000
J.	100,000	A.A.	789,000
L.D.	115,555	A.A.	447,600
E.Q.	122,917	A.D.	383,333
I.O.	137,000	B.	435,999
E.L.	138,800	B.T.	225,000
		C.	294,000
		C.	299,120
		E.K.T.	438,000
		S.	433,333
		X.S.	369,000
		I.Gj.K.	225,000
		L.S.	412,000
		O.H.	448,000
		O.T.	416,667
		P.S.	550,000
		R.	227,000
		S.Rr.	768,000

Burimi: Të dhëna të AKB të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

- Me shkresën nr. 2869/7 prot., datë 21.11.2022 ka dalë urdhër nr. 179, datë 21.11.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të mallit sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje tonera dhe drum për printerat në përdorim të AKB-së”. Komisioni përbëhet nga L.Sh., E.R. dhe K.N.

- Me shkresën nr. 2869/8 prot., datë 21.11.2022 është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim të mallit nga grupi i ngritur me urdhrin nr.179, datë 21.11.2022 duke deklaruar se malli i furnizuar nga “B.S.” është plotësisht në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit dhe merret në dorëzim nga përfaqësuesit e AKB-së.

Në dosjen e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje tonera për printerat për nevoja të AKB-së për vitin 2024” nuk është nënshkruar kontratë ndërmjet palëve, në kundërshtim me përcaktimet e parashikuara në nenin 85 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku parashikohet lidhja e kontratës si pjesë e dokumenteve të

procedurës së prokurimit, nenin 56 pika 10 ku citohet se “Faturat e lëshuara kanë vlerën e kontratës së lidhur, kur palët nuk kanë mundur të nënshkruajnë një të tillë”.

- Gjithashtu, në dosjen e procedurës së prokurimit nuk është hartuar raporti përmbledhës, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të parashikuara në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku kërkohet që për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji, autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim ku duhet të përfshijë të dhënat e AK, emrat e kandidatëve të kualifikuar dhe atyre të skualifikuar etj.

Nga auditimi mbi kriteret e veçanta të kualifikimit konstatohet se, argumentimi i dhënë është i përgjithshëm dhe nuk shpreh teknikisht nevojën e këtyre kriterëve për realizimin e kontratës kjo në kundërshtim me nenin 78 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”, ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

Komisioni nuk ka asnjë nga anëtarët ekspert të fushës, në kundërshtim me nenin 75/1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 i cili parashikon se komisioni i vlerësimit të ofertave përbëhet nga jo më pak se tre persona, ku të paktën një prej anëtarëve është ekspert i fushës.

Gjithashtu nga auditimi u konstatua se për procedurën me objekt “Blerje tonera dhe drum për printerat në përdorim të AKB-së” mungon formulari i njoftimit të fituesit.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1077/4 prot., datë 26.12.2024 “Mbi Projekt Raportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: ... nënshkrimi i një kontrate është në varësi të procedurës që zhvillohet dhe llojit të blerjes që kryhet, nëse prokurimi është për një shërbim që ka një vazhdimësi të caktuar ose shërbim vjetor, ose është një kontratë furnizimi që parashikon afate të caktuara lëvrimi, kontrata është e nevojshme të nënshkruhet, në të kundërt, për shërbime/ punë/ mallra që kryhen menjëherë, fatura tatimore e lëshuar sipas parashikimeve të legjislacionit tatimor ka vlerën e kontratës.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sqarojmë se, lidhja e kontratës ndërmjet OE dhe AK është detyrim ligjor i parashikuar në dispozitat ligjore në fuqi. Përsa i përket pikës 10 të nenit 56, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, faturat kanë vlerën e kontratës së lidhur vetëm kur palët nuk kanë mundur të nënshkruajnë një të tillë pa përcaktuar kryerjen e menjëhershme të shërbimit/ punës apo mallit që ofrohet apo vazhdimësinë e tij. Për sa më lart, grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.

Pretendimi i subjektit: ... “Raporti përmbledhës për procedurën e prokurimit gjenerohet automatikisht nga të dhënat e administruara në rrugë digjitale në Sistemin e Prokurimit Elektronik për procedurën e prokurimit”. Në dosjet e prokurimit me vlera të vogla ndodhet klasifikimi përfundimtar. ...

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sqarojmë se, në asnjë prej dosjeve të procedurave të prokurimeve me vlerë të vogël nuk ndodhet raporti përmbledhës që parashikohet në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ku thuhet se për çdo kontratë ose marrëveshje kuadër që mbulohet nga ligji autoriteti kontraktor duhet të hartojë një raport me shkrim dhe në këto nene nuk përjashtohet procedura e prokurimit me vlerë të vogël. Klasifikimi përfundimtar nuk përfshin elementët përkatës të raportit përfundimtar. Për sa më lart, grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.

Pretendimi i subjektit: ... Për procedurat me vlera të vogla nuk ka një formular standard njoftimi fituesi siç është tek procedurat e tjera me vlerë mbi kufirin monetar të berjeve me vlera të vogla. Njoftimi i fituesit, siç dhe përcaktohet në manual, krijohet automatikisht nga sistemi

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sqarojmë se, sipas nenit 32 të VKM nr. 285 njoftimi i fituesit duhet të jetë pjesë e dosjes së prokurimit publik për çdo procedurë duke mos përjashtuar ato

me vlerë të vogël. Gjithashtu e përcaktuar edhe në nenin 83 të po kësaj VKM-je e cila përcakton se pas përfundimit të procesit të vlerësimit të ofertave, autoriteti/enti kontraktor bën klasifikimin përfundimtar dhe harton njoftimin e fituesit. Për sa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.

III.2.2 Auditimi i Sistemeve


Objektivi i auditimit të sistemeve dhe kontrolleve të aplikacioneve, për të dhënat Input / Output që AKB ka në përdorim, është vlerësimi mbi efektivitetin e ndërtimit, operimit të kontrolleve të brendshme dhe saktësinë e funksionaliteteve që lidhen me procese të automatizuara si rezultat i zhvillimit informatik, që inspektorati ka pasur gjatë viteve.

Në përmbushje të drejtimit të auditimit “Auditimi i sistemeve”, u shqyrtuan dokumentacionet e mëposhtme:

- Përshkrim i përgjithshëm i sistemit të teknologjisë së informacionit në AKB;
- Të dhënat e gjeneruara nga sistemi për shërbimet e ofruara;
- Aktet rregullative të inspektoratit që lidhen me sistemet dhe veprimet operacionale brenda dhe jashtë sistemit;
- Manualet e përdorimit të sistemit;
- Intervista të drejtpërdrejta me punonjësit;
- Analizë e performancës së sistemit;

Për periudhën nën auditim AKB është përdorues i sistemit “e-inspektimi”. Ky sistem administrohet nga AKSHI dhe Inspektorati Qendror.

Fig 2. Ndërfaja e sistemit e-Inspektimi



Sistemi i inspektimeve “e-Inspektimi” i mundëson inspektorateve shtetërore mjetet e nevojshme për të realizuar më lehtë proceset e tyre inspektuese dhe monitoruese konform ligjeve në fuqi. Ky sistem mbulon të gjitha informacionet e nevojshme për të përgatitur dhe të kryer një procedurë inspektimi.

Veprimtaria e përditshme e inspektorateve shtetërore dhe e inspektorëve pasqyrohet në portalin unik të inspektimit “e-Inspektimi” dhe versionin mobile “e-Inspektimi”. Në mbështetje të këtij portali, Inspektorati Qendror ka të instaluar dhe konfiguruar një infrastrukturë qendrore hardware e cilat është e hostuar në Data Centerin Qeveritar, pranë AKSHI-t.

Komponentët kryesorë të këtij sistemi janë:

Komponentët e sistemit online “e-Inspektimi”, në versionin web janë:

- Moduli i Portalit e-Inspection, i cili shërben si panel për administrimin e përmbajtjes që duhet të shfaqen në website-in www.e-inspektimi.gov.al.

- Moduli i të dhënave të inspektorit, i cili shërben për menaxhimin e përdoruesve, inspektorateve që përdorin sistemin.
- Moduli i Programimit, i cili shërben për konfigurimin e programeve vjetore, mujore dhe krijimin e gjenerimit e çështjeve brenda planit.
- Moduli i Njohurive dhe të Mësuarit, i cili shërben për konfigurimin e listave verifikuese që përdoren gjatë inspektimeve.
- Moduli i Administrimit të Çështjeve të Inspektimit, i cili shërben për krijimin e çështjeve jashtë planit dhe procedimin e çështjeve brenda apo jashtë planit sipas hapave përkatës që ndiqen gjatë një procesi inspektimi. Ky modul përfshin Sistemin e Administrimit të Inspektimeve (Case Administration Management System - CAMS), Sistemin e administrimit të Dokumenteve (Documents Management System - DMS) dhe Sistemi i Arkivimit të Dokumenteve (Records Management System - RMS).
- Moduli i Riskut, i cili shërben për konfigurimet e faktorëve të riskut që ndikojnë në vlerësimin e riskut të subjektit, dhënien e vlerësimit nga inspektori për çdo faktor risku brenda çështjes nën inspektim dhe më pas përlllogaritjen automatike finale të riskut të çdo subjekt që inspektohet, sipas formulave të specifikuar nga IQ (Inspektorati Qendror).
- Moduli i Subjekteve dhe i të dhënave të Objekteve të Inspektimit, i cili shërben për ruajtjen e subjekteve që mund të inspektohen dhe aktivitetet përkatëse në të cilat operojnë subjektet.
- Moduli i Raporteve, i cili shërben për shfaqjen e raporteve të ndryshme statistikore për Inspektoratin Qendror dhe Inspektoratet Shtetërore.
- Moduli i ndërveprimit dhe komunikimit shërben për shkëmbimin e të dhënave me sistemet institucionale të tjera pjesë e rrjetit GovNet.
- Komponentët e sistemit online “*e-Inspektimi*”, në versionin Mobile janë:
- Modulin e mbledhjes së të dhënave të shërbimeve të të gjitha llojeve të Inspektorateve në nivel kombëtar, nëpërmjet rrjetit 4G/LTE.
Modulin e menaxhimit të të dhënave - të rendisë dhe ruajtë informacionet (raportet) e gjeneruara gjatë punës së përditshme. Të dhënat duhet të jenë të organizuara në tabelë të detajuara, në mënyrë që informacioni i ruajtur lehtësisht në to, të jetë lehtësisht i lexueshëm dhe i përdorshëm për të krijuar raporte sipas nevojës së IQ.
- Modulin e raportimeve on-line - duhet të gjenerojë raporte të optimizuara nga databaza qendrore.
- Moduli i menaxhimit në Back Office - të mundësojë konfigurimet e ndryshme në çdo kohë në përputhje me ndryshimet që mund të ketë legjislacioni i përditësuar, menaxhimin e përdoruesve, të drejtave dhe kufizimeve, azhurnimeve të nevojshme për aplikacionet nëpër termialet (tabletat) që janë në përdorim nga Inspektorët në gjithë vendin.
- Moduli i suportit teknik (help desk) - të ofrojë shërbimin e suportit teknik dhe këshillimit procedural për Inspektorët, si dhe për të gjithë qytetarët apo subjektet e interesuara.
- Modulin/ndërfaqen që bën të mundur për nënshkrimin elektronik të Aktit të Inspektimit. (nëpërmjet tabletit).
- Moduli i sinkronizimit të të dhënave - të mundësojë sinkronizimin e të dhënave nga tableta në server dhe anasjelltas në mënyrë që aplikacioni të jetë i përdorshëm edhe kur nuk ka rrjet 4G/LTE, në modalitetin "offline".
- Modulin/ndërfaqen për mundësimin e regjistrimit të të dhënave për pozicionimin gjeografik, si dhe regjistrimin e plotë elektronik të çështjes së inspektimit në Infrastrukturën e Serverave.

Verifikim i kontrolleve të aplikacioneve për të dhënat Input/Output

I.Sistemi e-inspektimi

Auditimi mbi sistemet e teknologjisë së informacionit u fokusua në sistemin e quajtur “e-inspektimi” i cili është sistemi kryesor për administrimin e procesit të inspektimeve në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit.

Veprimtaria inspektuese e AKB-t si dhe mbikëqyrja e kësaj veprimtarie, kryhet online, nëpërmjet sistemit elektronik “e-Inspektimi”. “e-Inspektimi” është portali unik i inspektimit, që

shërben për programimin dhe bashkërendimin e inspektimeve, për kryerjen e veprimtarisë së inspektimeve online, mbikëqyrjen e veprimtarisë inspektuese, shkëmbimin e të dhënave ndërmjet Inspektorateve Shtetërore / Vendore / Trupat e tjera inspektuese, sistemeve të tjera të dixhitalizuara të administratës shtetërore.

AKB nuk disponon sistem të vetin elektronik, për kryerjen e inspektimit online, por sistemi në të cilin regjistrohen, ndiqen dhe administrohen këto të dhëna për të gjithë inspektoratet në vend është sistemi “e-inspektimi”. Ky sistem është administruar deri në vitin 2017 nga Inspektorati Qendror (IQ), ndërsa që prej vitit 2018 administrohet nga AKSHI. Aktualisht, ofruesi dhe mirëmbajtësi i këtij sistemi është Agjencia Kombëtare e Shërbimit të Informacionit (AKSHI). Hyrja dhe identifikimi i përdoruesve të sistemit e-inspektimi kryhet me emër përdoruesi dhe fjalëkalim. Zgjidhja aktuale e sistemit “e-Inspektimi” është konceptuar të aksesohet në web që mund të aksesohet nga të gjithë përdoruesit nëpërmjet çdo pajisje që ka qasje në internet pa pasur nevojë për instalime të programeve specifike. Sistemi përdor ASP.NET Web Forms 4.7.2 dhe SharePoint 2016 si dhe disa komponentë të rinj përdorin ASP.NET MVC 5 dhe ASP.NET Web API 2 (që janë pjesë e ASP.NET) për të mbështetur aplikimin e ri për tableta i cili është ndërtuar në një teknologji me React Native.

Nga auditimi mbi manualin e përdorimit të aplikacionit “e- Inspektimi” u konstatua se:

-Manualin e sistemit janë hartuar që në vitin 2017, vetëm në versionin fillestar që janë gjeneruar në momentin që është implementuar sistemi dhe nuk kanë pësuar asnjë ndryshim, përditësim, pavarësisht ndryshimeve të ndodhura në funksionalitetin e sistemit, ndryshimet strukturore të burimeve njerëzore, etj.

-Manualin e përdorimit të sistemit nuk janë të ndarë sipas funksionaliteteve të inspektorateve, por të njëjtët manuale përdoren për të gjithë inspektoratet, pavarësisht fushës së veprimit qëmbulojnë. Rolet dhe përgjegjësitë nuk janë të reflektuar apo përditësuar në manualin e sistemit.

Nga auditimi mbi funksionalitetin e sistemit e-inspektimi u konstatua se:

-Në momentin kur inspektori në çështjen përkatëse e krijon si ri-inspektim ato në sistem dalin të krijuara dy herë;

Inspektorët duhet të përdorin internetin e tyre ose të subjektit që po inspektojnë për të ngarkuar dhe sinkronizuar çështjen me të cilën po punojnë, pasi pajisjet tablet nuk kanë internet për ta kryer këtë proces.


Përgjatë viteve 2023-2024 janë hasur raste në versionin web dhe mobile ku sistemi nuk hapej dhe shfaqte error: “Service is unaviable” dhe “HTTP error 503”;

-Në disa raste në versionin web të sistemit e-inspektimi është hasur një error i cili shfaqej: “Lidhje me serverin dështoi”;

-Kur një përdorues identifikohet dhe më pas çidentifikohet nga e-inspektimi në web, mund të hyjë përsëri pa pasur nevojë të ruajë ose të rifusë fjalëkalimin. Kjo tregon për menaxhim të papërshtatshëm të sesionit.

Sistemi CMS

Figura nr. 34 Pamje nga ndërfaqet kryesore të sistemit CMS



Sistemi i menaxhimit CMS (content Management System) të lejeve të plazhit është një platformë e prokuruar dhe menaxhuar nga AKSHI. AKB vepron si përdorues në këtë sistem për të vërtetuar nëse subjektet plotësojnë kriteret për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi duke u bazuar në dokumentacionin e ngarkuar në sistem me anë të sistemit e-Albania.

Hapat e procedurës

Identifikimi në portalin e-Albania; - Zgjidhet shërbimi "Kërkesë për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi";

- Kërkesa e paraqitur i shkon për shqyrtim Grupit Teknik të Shqyrtimit të Aplikimeve (GTSHA);

- Pas shqyrtimit të kërkesave, në rast se konstatohet mungesë apo paqartësi dokumentacioni, GTSHA-ja njofton menjëherë subjektin nëpërmjet portalit e-Albania për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm;

- Në rast se subjekti nuk i plotëson kriteret dhe/ose dokumentacioni pas kërkesës për plotësim mbetet i paplotësuar brenda afatit të kërkuar, GTSHA-ja refuzon përfundimisht kërkesën nëpërmjet portalit e-Albania;

Faza II (Negocimin) Në rast se subjekti plotëson kriteret dhe dokumentacioni i paraqitur rezulton i plotë, GTSHA-ja njofton subjektin nëpërmjet portalit e-Albania dhe njofton elektronikisht Agjencinë Kombëtare të Bregdetit dhe Njësinë përkatëse të Vetëqeverisjes Vendore, me qëllim plotësimin e dokumentacionit shtesë si më poshtë:

- Planvendosja përkatëse për sipërfaqen konkrete të miratuar të stacionit të plazhit, pas negociimit midis subjektit të kualifikuar dhe NJVV që do të jepet për shfrytëzim si stacion;

- Gjenerimi i mandat pagesës vjetore të sipërfaqes së stacionit të plazhit, nga ana e NJVV si palë përfituese, sipas tarifave vendore në fuqi ku të detajohet detyrimi financiar vjetor për përdorimin e sipërfaqes së stacionit të plazhit dhe për ngritjen dhe shfrytëzimin e strukturave të shërbimit, sipas rastit, si dhe vërtetimi i pagesës së kryer nga ana e subjektit. Përgjashtimisht, subjektet, që paraqesin kërkesën për lidhjen e kontratave për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazheve, sipas shkronjës "ç", të pikës 7, të nenit 14, paraqesin gjenerimin e

mandatpagesës të përcaktuar më lart, nëpërmjet portalit e-Albania, para nënshkrimit të kontratës;

- Pajesa e detyrimit në bashki për sipërfaqen e miratuar të strukturës së shërbimit në brezin e shërbimeve të stacionit të plazhit, në rast se subjekti kërkon vendosjen e strukturës së shërbimit në brezin e shërbimeve të stacionit të plazhit;

- Vërtetimi nga autoritetet tatimore se subjekti ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore.

Faza III (Lidhja e kontratës dhe lëshimi certifikatës)

- Pas plotësimit të dokumentacionit shtesë si më sipër, GTSHA-ja miraton në portalin e-Albania kërkesën përkatëse dhe AKB-ja njofton menjëherë subjektin dhe NJVV-në për nënshkrimin e kontratës. Para nënshkrimit të kontratës, subjekti duhet të paraqesë marrëveshjen e noterizuar me vrojtuesin e plazhit (shoqëruar me certifikatën përkatëse të kualifikimit), e vlefshme përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, si dhe vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit për miratimin e stacioneve të plazhit, vetëm për subjektet që kanë kërkuar lidhjen e kontratave për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazheve, sipas shkronjës “ç”, të pikës 7, të nenit 14.”;

- Në përfundim të nënshkrimit të kontratës, subjekti pajiset me certifikatën e përdorimit të stacioneve të plazhit.

Nga auditimi u konstatuan Porta të panevojshme të hapura në Serverin e Webit

Gjatë një skanimit të rrjetit të serverit të webit, u zbuluan disa porte të hapura, duke ekspozuar shërbime potencialisht të panevojshme. Portet e mëposhtme u identifikuan:

- 80 (HTTP): Trafiku i paenkriptuar i webit.
- 443 (HTTPS): Trafiku i sigurt i webit (HTTPS).
- 2083 (cPanel mbi HTTPS): Akses i sigurt në cPanel.
- 2086 (WHM mbi HTTP): Akses i pasigurt në WHM (Menaxheri i Web Hosting).
- 2087 (WHM mbi HTTPS): Akses i sigurt në WHM.
- 8080 (alternativë për HTTP): Port alternativ për trafikun HTTP.
- 8443 (alternativë për HTTPS): Port alternativ për trafikun HTTPS.
- 8880 (alternativë për Plesk HTTP): Trafiku i pasigurt i Plesk.

Prania e portave të shumta të hapura rrit hapsirën e sulmit të serverit në internet, veçanërisht aty ku ekspozohen protokollat e pasigurta ose ndërfaqet administrative. Portet si 2086 (WHM mbi HTTP) dhe 8880 (Plesk mbi HTTP) po transmetojnë të dhëna në një format të pakriptuar, duke i bërë ato të prekshme ndaj përgjimit. Portet alternative të hapura si 8080 dhe 8443 jenë gjithashtu të panevojshme dhe mund të shfrytëzohen nga sulmuesit.

Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike dhe aksesit në rrjet

Verifikimi i shkallës së sigurisë së dhomës së serverave me qëllim parandalimin e humbjes ose të dëmtimit të pajisjeve kompjuterike, aksesit të paautorizuar, kopjimit ose shikimit të informacionit sensitiv. Auditimi mbi shkallën e sigurisë së dhomës së serverave u krye në bazë të manualit të auditimit IT, ISSAI 5310 dhe ISO 27001

Nga auditimi i Infrastruktura Network dhe pajisjeve ndihmëse që nevojiten për shërbimet e komunikimit dhe ruajtjes së të dhënave është në kushtet jo minimale dhe optimale, ku shërbimet e ngritura mbi këto rrjete nuk janë të sigurta dhe nuk mbështesin vazhdimësinë e punës. Pajisjet e jashtme që lidhen në rrejt kanë akses në internet dhe mund të shohin listën e printerave të lidhur në rrjet. Kompjuterat (PC) që ndodhen në çdo zyrë nuk janë të pajisura me antivirus për mbrojtje ndaj sulmeve.

IV. REKOMANDIME

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit nuk ka asnjë punonjës të teknologjisë së informacionit. Për çdo problem që konstatohet në përdorimin e pajisjeve teknologjike apo sistemet që punonjësit e institucionit kanë në përdorim i përcillet për zgjidhje Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka dërguar kërkesa të vazhdueshme drejtuar AKSHI-të për emërimin e një punonjësi të teknologjisë së informacionit në AKB për realizimin në kohë dhe mbarëvajtjen e proceseve të punës në këtë institucion por ende nuk është caktuar një punonjës. Mungesa e një punonjësi të dedikuar pengon veprimtarinë e institucionit për veprime operationale të vazhdueshme.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1 faqe 9-24, të Raportit të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit të marrin masa të menjëhershme për plotësimin me punonjës të teknologjisë së informacionit në AKB.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2025

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nuk janë marrë masa për hartimin e rregullave dhe procedurave që normojnë proceset e teknologjisë së informacionit në përputhje me aktet ligjore, nënligjore dhe praktikat më të mira. Mungesa e një baze të brendshme procedurale rregullatore për funksionimin e strukturave të teknologjisë së informacionit çon në operim bazuar në ngjarje “ad hoc”, duke rritur rrezikun e ekspozimit të institucionit ndaj situatave të mundshme.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1 faqe 9-24, të Raportit të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të analizojë situatën dhe të marrë masa për hartimin e një Rregulloreje të Përgjithshme mbi Teknologjinë e Informacionit, duke marrë në konsideratë vendosjen e kontroleve të brendshme lidhur me menaxhimin e riskut, përputhshmërinë me procedurat dhe rregullat e brendshme aktuale të funksionimit të saj.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Agjencia Kombëtare e Bregdetit nuk disponon regjistër risqesh për vitet 2022-2023, si dhe nuk kanë të dokumentuar risqe të identifikuar. Për vitin 2024 është hartuar regjistri i riskut, por nuk rezultoi të jenë identifikuar risqe që lidhen me teknologjinë e informacionit.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1 faqe 9-24, të Raportit të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa për identifikimin e risqeve që sjellë teknologjia e informacionit në aktivitetin dhe arritjen e objektivave të saj, si dhe të analizojë, vlerësoj dhe adresojë ato në strukturat përgjegjëse me qëllim minimizimin e tyre dhe përditësimin e regjistrit të riskut.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Agjencia Kombëtare e Bregdetit nuk ka nënshkruar një marrëveshje për shërbimet që merr nga AKSHI me qëllim përcaktimin e nivelit të shërbimit që ky i fundit duhet t'i ofrojë këtij institucioni, mënyrat e raportimit, parametrat, përgjegjësitë, kufizimet etj.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1 faqe 9-24, të Raportit të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të marrin masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e marrëveshjes dypalëshe me qëllim përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve për shërbimet TIK që ofron AKSHI.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2025

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi manualët e përdorimit të aplikacionit “e- inspektimi” u konstatua se:

- Manualët e sistemit janë hartuar në vitin 2017, vetëm në versionin fillestar që janë gjeneruar në momentin që është implementuar sistemi dhe nuk kanë pësuar asnjë ndryshim, përditësim, pavarësisht ndryshimeve të ndodhura në funksionalitet e sistemit, ndryshimet strukturore të burimeve njerëzore etj.

- Manualët e përdorimit të sistemit nuk janë të ndarë sipas funksionaliteteve të inspektorateve, por të njëjtët manuale përdoren për të gjithë inspektoratet, pavarësisht fushës së veprimit që mbulojnë. Rolet dhe përgjegjësitë nuk janë të reflektuar apo përditësuar në manualët e sistemit.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2 faqe 24-28, të Raportit të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të analizojë situatën dhe në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror të adresojë tek ofruesi i shërbimit të mirëmbajtjes mangësitë mbi manualët e përdorimit të sistemit e-inspektimi duke reflektuar ndryshimet institucionale, strukturore dhe kompjuterike të ndodhura në inspektoratet shtetërore.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit “e-Inspektimi” u konstatuan disa problematika mbi funksionalitet e sistemit:

- Në momentin kur inspektori në çështjen përkatëse e krijon si ri-inspektim ato në sistem dalin të krijuara dy herë.

- Inspektorët duhet të përdorin internetin e tyre ose të subjektit që po inspektojnë për të ngarkuar dhe sinkronizuar çështjen me të cilën po punojnë, pasi pajisjet tablet nuk kanë internet për ta kryer këtë proces.

- Përgjatë viteve 2023-2024 janë hasur raste në versionin web dhe mobile ku sistemi nuk hapej dhe shfaqte error: “Service is unaviable” dhe “HTTP error 503”. Në disa raste në versionin web të sistemit e-inspektimi është hasur një error i cili shfaqej: “Lidhje me serverin dështoi”.

Kur një përdorues kryen procesin e daljes nga sistemi (“log-out”) në platformën e e-inspektimit në web, ky proces nuk përfundon siç duhet. Si rezultat, përdoruesi mund të aksesojë sërish sistemin pa pasur nevojë të fusë fjalëkalimin, duke krijuar një rrezik për sigurinë e informacionit.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2 faqe 24-28, të Raportit të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të raportojë te Inspektorati Qendror problematikën në sistemin e-Inspektimi të konstatuara nga auditimi mbi funksionalitetin e shërbimeve si institucioni qendror për analizimin dhe adresimin tek ofruesi i shërbimit të mirëmbajtjes.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi sigurinë e sistemit të menaxhimit CMS u konstatuan porta të hapura të panevojshme, si 2086, 8880, 8080, 8443, të cilat mund të krijojnë vulnerabilitete serioze në këtë sistem. Këto porta mund të ekspozojnë shërbime që nuk janë të nevojshme për funksionimin e sistemit dhe mund të përdoren nga sulmuesit për të fituar akses të paautorizuar.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2 faqe 24-28, të Raportit të Auditimit)

Gjithashtu, transmetimi i të dhënave në një format të pakriptuar (p.sh. HTTP) rrit mundësinë për përgjim dhe manipulim të të dhënave.

7.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit duhet të marrë masa për të reduktuar rrezikun nga portat e panevojshme të hapura, duke realizuar një skanim të plotë të rrjetit për të identifikuar dhe mbyllur të gjitha portat jo-thelbësore, si 2086, 8880 dhe 8080. Gjithashtu, duhet të përmirësojë rregullat e firewall-it dhe të çaktivizojë shërbimet e papërdorura për të forcuar sigurinë e sistemit.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i infrastrukturës së rrjetit dhe pajisjeve ndihmëse që nevojiten për shërbimet e komunikimit dhe ruajtjes së të dhënave, u konstatua se gjendja e tyre nuk është në kushte optimale. Shërbimet e ngritura mbi këto rrjete nuk janë të sigurta dhe nuk garantojnë vazhdimësinë e punës. Kompjuterët (PC) që ndodhen në çdo zyrë nuk janë të pajisur me antivirus për mbrojtje ndaj sulmeve, duke rritur kështu rrezikun e ekspozimit ndaj kërcënimeve të mundshme.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2 faqe 24-28, të Raportit të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit në bashkëpunim me AKSHI-n, duhet të marrë masa për përmirësimin, pajisjen dhe standardizimin e infrastrukturës TIK për punonjësit e administratës së AKB, me qëllim krijimin e kushteve optimale që mundësojnë përmbushjen e detyrave gjatë veprimtarisë së punës dhe sigurojnë mbarëvajtjen e punës pa ndërprerje.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

- Në tre nga pesë dosjet e procedurave të prokurimit publik të marra në shqyrtim nuk ka një raport përmbledhës sipas përcaktimeve në nenin 99 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021.

- Për procedurat e prokurimit: “Blerje tonera dhe drum për printerat në përdorim të AKB-së, viti 2022”, “Blerje tonera për printera për nevoja të AKB-së për vitin 2023” dhe “Blerje tonera për printera për nevoja të AKB-së për vitin 2024” formularët e njoftimit të fituesit nuk janë pjesë e dosjeve të prokurimit në zbatim të nenit 97 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në nenet 32 dhe 83 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”.

- Për procedurën me objekt “Shërbim për përshtatje dhe zhvillim të faqes web zyrtare të AKB-së, 2023” sipas urdhrit të miratuar nga titullari i institucionit komisioni i ngritur brenda datës 31.05.2023 duhet të hartojë një relacion përmbledhës dhe t’i paraqitet titullarit të institucionit në mënyrë të detajuar gjendja aktuale e faqes zyrtare të AKB-së. Ky raport përmbledhës nuk është hartuar dhe nuk i është paraqitur titullarit sipas afateve të kërkesës në urdhrin e ngritur nga vetë titullari, por është hartuar në datën 20.06.2023 më vonë se data e përcaktuar në urdhr.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1 faqe 9-24, të Raportit të Auditimit)

9.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe zyrtarët e angazhuar në procedurat e prokurimit të marrin masa që për çdo procedurë prokurimi që do të zhvillohet në vijimësi të përmbushen përcaktimet e dispozitave ligjore dhe rregullative në fuqi.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në dosjet e procedurave të prokurimit me objekt “Blerje tonera për printerat për nevoja të AKB-së për vitin 2024” dhe “Blerje tonera dhe drum për printerat në përdorim të AKB-së për vitin 2022” nuk është nënshkruar kontratë ndërmjet palëve, në kundërshtim me përcaktimet e parashikuara në nenin 85 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku parashikohet lidhja e kontratës si pjesë e dokumenteve të procedurës së prokurimit, nenin 56 pika 10.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1 faqe 9-24, të Raportit të Auditimit)

10.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa në cilësinë e Autoritetit Kontraktor për procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijimësi të lidhë kontratë me Operatorin Ekonomik fitues në zbatim të dispozitave ligjore dhe nënligjore që përcaktojnë këtë detyrim.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për procedurat “Blerje tonera dhe drum për printerat në përdorim të AKB-së për vitin 2022”, “Blerje tonera për printera për nevoja të AKB-së për vitin 2023” dhe “Blerje tonera për printera për nevoja të AKB-së për vitin 2024”:

- Mbi kriteret e veçanta të kualifikimit nuk është dhënë argumentimi teknik i nevojës së këtyre kriterëve për realizimin e kontratës në kundërshtim me nenin 78 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për “*Miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar”.

- Në procedurat e prokurimit të audituara në asnjë fazë të zhvillimit të procedurës nuk ka pasur një ekspert të fushës, në kundërshtim me nenin 74 dhe 75 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1 faqe 9-24, të Raportit të Auditimit)

11.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit të marrë masa duke caktuar ekspertë të fushës në hartimin e specifikimeve teknike, si dhe të kriterëve të veçanta kualifikuese, në komisionet e vlerësimit të ofertave, për procedurat e blerjeve të vogla që janë investime apo shërbime në Teknologjinë e Informacionit.

Gjithashtu, të marrin masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të kryhet argumentimi ligjor dhe teknik i të gjitha kriterëve të vendosura.

Në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT